



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**  
**AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA**  
**DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Shpallet 1(një) vendi vakant me kontratë, **Magaznier – Klasa e pagës V**, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

**1- Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin:** Magaznieri është personi përgjegjës për administrimin fizik dhe dokumentar i pasurive materiale në magazinë, duke siguruar ruajtjen, qarkullimin dhe evidentimin korrekt të tyre sipas rregullave të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

**Detyrat kryesore:**

- Regjistron çdo hyrje dhe dalje në kartelat e magazinës ose sistemin elektronik, për realizimin e aktivitetit të AAPSK.
- Realizon rakordimin e lëvizjes së mallrave nga magazina me sektorin e financës në mënyrë periodike gjatë vitit dhe në fund të vitit ushtrimor.
- Merr pjesë në inventarizime periodike dhe vjetore, bashkëpunon me komisionet e inventarizimit dhe zbaton rekomandimet e tyre.
- Mirëmban magazinën dhe kujdeset për gjendjen e mallrave, për të ruajtur vlerën e tyre.
- Kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**2- Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion.**

**Kritere të përgjithshme:**

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të njohë mire gjuhën shqipe;
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm, arsimi i lartë në fushën e ekonomisë përbën avantazh;
- Të ketë integritet të lartë profesional e moral;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të programeve bazë të kompjuterit.
- Të ketë leje drejtimi automjeti.
- Vlerësohet të ketë eksperiencë të mëparshme në këtë profil/profesion;

**3- Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.**

Kandidatët do të intervistohen në lidhje me:

- Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e Punëdhënësit e Punëmarrësit;
- Njohuri mbi ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 i Ministrisë së Financave, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar;

#### **4- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve dhe zhvillimi i intervistës për përzgjedhjen e kandidatëve:**

4.1 Aplikantët brenda 10 ditëve kalendarike nga data e shpalljes, duhet të dorëzojnë dokumentet pranë AAPSK:

1. *Kërkesë për punësim;*
2. *Jetëshkrim;*
3. *Diplomë e shkollës së mesme të noterizuar së bashku me listë notash; Në rast të aplikantëve me arsim të lartë duhet diploma e noterizuar;*
4. *Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);*
5. *Fotokopje të letërnjoftimit (ID);*
6. *Vërtetim të gjendjes shëndetësore;*
7. *Vërtetim të gjendjes gjyqësore;*
8. *Dëshmi Penaliteti*

Dokumentacioni i aplikantit duhet të dorëzohet në protokollin e AAPSK brenda dates **13.04.2026**.

4.2 AAPSK brenda datës **18.04.2026**, bën verifikimin paraprak të dosjeve të aplikantëve nëse plotësojnë kriteret specifike, të përcaktuara në këtë urdhër. Në përfundim të këtij afati, AAPSK shpall në ambientet e tij dhe në faqet zyrtare, listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere për t’iu nënshtruar konkursit, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

4.3 Kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret specifike, njoftohen nga Komisioni i “Ad-Hoc” dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë kësaj agjencie, për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen në AAPSK brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e listës, sipas pikës 3 të këtij urdhri. AAPSK duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, AAPSK shpall listën e kandidatëve që do të nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

4.4 Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi janë bazuar në:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit, letër motivimit, eksperiencën në punë, aftësi dhe kualifikime (50 Pikë)
- b) Intervista e strukturuar me gojë (50 Pikë)

4.5 Zhvillimi i intervistës me aplikantët e përzgjedhur nga komisioni “Ad-Hoc” do të kryhet brenda datës **23.04.2026**, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

4.6 Lista e kandidatëve fitues të renditur me mbi 70 pikë shpallet në faqen zyrtare dhe në ambientet e AAPSK.

4.7 Kandidatët që nuk janë shpallur fitues, kanë të drejtë të ankohen me shkrim pranë AAPSK, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultatit.

4.8 Shpallja e fituesit bëhet pas kalimit të afatit 7 ditë kalendarike nga përfundimi i intervistës.

4.9 Fitues shpallet kandidati që ka fituar pikët më të larta në listen e kandidatëve fitues.